

“EUROGREN” Sh.p.k
Pasqyrat Financiare për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2015

PËRMBAJTJA:

	FAQE
PASQYRAT FINANCIARE:	
PASQYRA E POZICIONIT FINANCIAR	2
PASQYRA E PERFORMANCËS	3
PASQYRA E NDRYSHIMEVE NË KAPITAL	4
PASQYRA E FLUKSIT TË MJETEVE MONETARE	5
SHËNIMET SHPJEGUESE TË PASQYRAVE FINANCIARE	6 - 19

EUROGREN Sh.p.k
Pasqyrat Financiare për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2015

(Vlerat janë në Lek)

Pasqyra e Pozicionit Financiar
më 31 dhjetor 2015

	Shënime	31 Dhjetor 2015	31 Dhjetor 2014
Aktive afatshkurtra			
Mjete monetare	4	49,980	38,874
Llogari të arkëtueshme tregtare	5	-	-
Llogari të arkëtueshme nga palët e lidhura	6	3,803,203	3,783,201
Të tjera llogari të arkëtueshme	7	6,685,030	6,759,259
Inventari	8	87,100	87,100
Total Aktive Afatshkurtra		10,625,313	10,668,434
Aktivet afatgjata			
Aktive afatgjata materiale	9	18,456,721	18,456,721
Aktive afatgjata jomateriale	10	1,568,700	1,568,700
Kapitali aksionar i pa paguar		1,494,000	1,494,000
Total aktive afatgjata		21,519,421	21,519,421
Total Aktive		32,144,734	32,187,855
DETYRIMET			
Detyrime afatshkurtra			
Llogari të pagueshme tregtare	11	328	328
Detyrime tatimore	12	22,678	22,678
Të tjera detyrime	13	329,073	329,073
Total Detyrime afatshkurtra		352,079	352,079
Detyrime afatgjata			
Llogari të pagueshme nga palët e lidhura	14	30,191,167	28,543,739
Provizione		152,398	152,398
Total Detyrime afatgjata		30,343,565	28,696,137
Totali i detyrimeve		30,695,644	29,048,216
Kapitali aksionar			
Kapitali i nënshkruar	15	51,776,625	51,776,625
Fitime të mbartura		(48,636,986)	(46,546,506)
Fitimi i ushtrimit		(1,690,549)	(2,090,480)
Total kapitali aksionar		1,449,090	3,139,639
Totali i kapitalit dhe detyrimeve		32,144,734	32,187,855

Pasqyrat financiare duhet të lexohen së bashku me shënimet shpjeguese nga faqja 6 deri në 19, të cilat janë pjesë përbërëse e këtyre pasqyrave financiare.

EUROGREN Sh.p.k
Pasqyrat Financiare për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2015

(Vlerat janë në Lek)

Pasqyra e Performancës
Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2015

	Shënime	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2015	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2014
Të ardhura nga aktiviteti i shfrytëzimit	16	1,800,000	1,680,000
Lënda e parë dhe materiale të konsumueshme	17	(642,345)	(642,901)
1) Të tjera shpenzime		(642,345)	(642,901)
Shpenzime të personelit	18	(1,008,288)	(1,008,288)
1) Paga dhe shpërblime		(864,000)	(864,000)
Shpenzime të sigurimeve			
2) shoqërore/shëndetësore		(144,288)	(144,288)
Të ardhura të tjera		-	-
Zhvlerësim i aktiveve financiare dhe investimeve të mbajtura si aktive afatshkurtra		-	-
Shpenzime financiare	19	(1,742,351)	(2,113,510)
Shpenzime interesi dhe shpenzime të			
1) ngjashme		(2,243,344)	(2,123,241)
2) Shpenzime të tjera financiare		500,993	9,731
Pjesë e fitimit/humbjes nga pjesëmarrjet			
Fitimi/humbja para tatimit		(1,592,984)	(2,084,699)
Shpenzimi i tatimit mbi fitimin	20	(97,565)	(5,781)
1) Shpenzimi aktual i tatimit mbi fitimin		(97,565)	(5,781)
Fitimi/humbja e vitit		(1,690,549)	(2,090,480)
Të ardhura të tjera gjithpërfshirëse për vitin		-	-
Totali i të ardhurave të tjera gjithpërfshirëse për vitin		-	-
Totali i të ardhurave gjithpërfshirëse për vitin		(1,690,549)	(2,090,480)

Pasqyrat financiare duhet të lexohen së bashku me shënimet shpjeguese nga faqja 6 deri në 19, të cilat janë pjesë përbërëse e këtyre pasqyrave financiare.

EUROGREN Sh.p.k
Pasqyrat Financiare për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2015

(Vlerat janë në Lek)

Pasqyra e ndryshimeve në Kapital
Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2015


	Kapitali i nënshkruar	Fitim / Humbja e vitit	Totali
Pozicioni më 1 janar 2014	51,776,625	(46,546,506)	5,230,119
Efekti i ndryshimeve në politikat kontabël			
Pozicioni financiar i rideklaruar më 1 janar 2014			
Të ardhura totale gjithpërfshirëse për vitin:			
Fitimi / Humbja e vitit		(2,090,480)	(2,090,480)
Të ardhura të tjera gjithpërfshirëse:			
Pozicioni më 31 dhjetor 2014	51,776,625	(48,636,986)	3,139,639
Pozicioni financiar i rideklaruar më 1 janar 2015			
Totali i të ardhura gjithpërfshirëse për vitin:			
Fitimi / Humbja e vitit		(1,690,549)	(1,690,549)
Të ardhura të tjera gjithpërfshirëse:			
Pozicioni më 31 dhjetor 2015	51,776,625	(50,327,535)	1,449,090

Pasqyrat financiare duhet të lexohen së bashku me shënimet shpjeguese nga faqja 6 deri në 19, të cilat janë pjesë përbërëse e këtyre pasqyrave financiare.

Pasqyrat financiare të Shoqërisë për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2015 janë aprovuar nga administratori i EUROGREN Sh.p.k më 25.03.2016 dhe janë firmosur si më poshtë.



Edmond Mersini
 Administrator



MAZARS

Mazars Sh.p.k.
 Rr. Et'hem Beutit, Pallat "Binjaket",
 Hartues i Pasqyrave Financiare
 Tiranë, Albanie
 phone: +355 42 27 80 15
 www.mazars.al . info@mazars.al

EUROGREN Sh.p.k
Pasqyrat Financiare për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2015

(Vlerat janë në Lek)

Pasqyra e Fluksit të Mjeteve Monetare
Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2015

Shënime	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2015	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2014
Flukset e parasë nga aktivitetet operative		
Fitim / Humbja e vitit	(1,690,549)	(2,090,480)
Shpenzimet për tatimin mbi fitimin jomonetar	1,824,892	2,113,510
Rënie/(rritje) në të drejtat e arkëtueshme dhe të tjera	(28,237)	119,145
Mjete monetare neto nga/(përdorur në) aktivitetin e shfrytëzimit	106,106	142,175
Fluksi i Mjeteve Monetare nga/(përdorur në) aktivitetin e investimit		
Mjete monetare neto nga/(përdorur në) aktivitetin e investimit	-	-
Fluksi i Mjeteve Monetare nga/(përdorur në) aktivitetin e financimit		
Pagesa e huave	(95,000)	(120,000)
Mjete monetare neto nga/(përdorur në) aktivitetin e financimit	(95,000)	(120,000)
Rritje/(rënie) neto në mjete monetare dhe ekuivalentë të mjeteve monetare	11,106	22,175
Mjete monetare dhe ekuivalentë të mjeteve monetare më 1 janar	38,874	16,699
Mjete monetare dhe ekuivalentë të mjeteve monetare më 31 dhjetor	49,980	38,874
4		

Pasqyrat financiare duhet të lexohen së bashku me shënimet shpjeguese nga faqja 6 deri në 19, të cilat janë pjesë përbërëse e këtyre pasqyrave financiare.

1. Informacion i përgjithshëm

“Eurogren” sh.p.k (Kompania) është themeluar si një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar me vendim gjykatë të rrethit Tiranë Nr.11574 datë 01.05.1996 në përputhje me Ligjin nr. 7638, datë 19.11.1992 “Për Shoqëritë tregtare”, si edhe nga statuti i saj.

Ortakët e shoqërisë janë:

Ministria e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjitikës që zotëron 29% të kapitalit;

Z.Edmond Mersini që zotëron 23.68% të kapitalit;

Z.Hasan Hafizi që zotëron 23.66% të kapitalit;

Znj. Mirela Mula që zotëron 23.66% të kapitalit.

Aktiviteti kryesor i kesëj shoqërie është prodhim, përpunim, tregtim, eksportim dhe importim të detaleve gjysëmfabrikate prej druri, të lëndëve drusore të gjithëfarlojshme të sharruar, artikujve të tornuar e të profiluar, makinerive të përpunimit të drurit, organizimit dhe kryerjes së shërbimit të transportit për mallrat e ndryshëm dhe pasagjerë, të ushqimit social etj. Aktiviteti i shoqërisë është parashikuar të jetë pa ndërprerje mbi 10 vjet.

Selia e shoqërisë është në adresën: Rr. “Konferenca e Pezës”, Nd.73, H.1, Njësia nr.6, Tiranë. Ajo është regjistruar në Degën e Tatimeve të rrethit Tiranë me Kod Fiskal 3705911 dhe NIPT J61814077J.

Më 31 dhjetor 2015 shoqëria kishte 2 punonjës (31 dhjetor 2014: 2 punonjës).

2. Bazat e përgatitjes së pasqyrave financiare

2.1. Deklarata e pajtueshmërisë

Pasqyrat financiare janë përgatitur në përputhje me Standardet Kombëtare të Kontabilitetit të përmirësuara (SKK) dhe ligjin nr.9228, datë 29 prill 2004 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”.

Në bazë të urdhrit nr. 64 datë 22.7.2014 “Për shpalljen e standardeve kombëtare të kontabilitetit të përmirësuara dhe zbatimin e detyrueshëm të tyre”, Ministria e financave vendosi të bëjë të detyrueshme zbatimin e Standardeve Kombëtare të Kontabilitetit të përmirësuara duke filluar nga 1 janar 2015.

Ky urdhër hyri në fuqi me fletoren zyrtare nr.119, datë 1 gusht 2014.

2.2. Bazat e matjes

Pasqyrat financiare janë përgatitur bazuar në koston historike.

2.3. Biznesi në vijimësi

Pasqyrat financiare të Shoqërisë përgatiten mbi supozimin e biznesit në vijimësi, i cili merr parasysh se Shoqëria do të vazhdojë ekzistencën e aktivitetit të saj për një të ardhme të parashikuar.

2.4. Monedha funksionale dhe e paraqitjes

Këto pasqyra financiare janë paraqitur në Lek, e cila është dhe monedha funksionale e Shoqërisë.

2.5. Vlerësime dhe gjykime

Paraqitja e pasqyrave financiare kërkon që manaxhimi i shoqërisë të kryejë vlerësime dhe supozime që ndikojnë shumat e raportuara të aktiveve, detyrimeve dhe aktiveve e detyrimeve të kushtëzuara në datën e pasqyrës së pozicionit financiar, si dhe të ardhurave dhe shpenzimeve të krijuara në periudhën kontabël.

2. Bazat e përgatitjes së pasqyrave financiare (vazhdim)

2.5 Vlerësime dhe gjykime

Vlerësimet dhe gjykimet rishikohen vazhdimisht dhe bazohen në eksperiencën e mëparshme dhe faktorë të tjerë duke përfshirë pritshmëritë për ngjarjet e ardhshme të cilat besohen të jenë të arsyeshme në rrethanat aktuale. Në disa raste manaxhimi mbështetet në mendimet e ekspertëve të pavarur.

Manaxhimi kryen vlerësime dhe gjykime në lidhje me të ardhmen. Vlerësimet kontabël që rezultojnë sipas përkufizimit, jo gjithmonë do të barazohen me rezultatet aktuale. Vlerësimet dhe supozimet që kanë risk të rëndësishëm për të shkaktuar korrigjime (axhustime) materiale, të vlerave të mbartura të aktiveve dhe detyrimeve janë përshkruar më poshtë:

2.5.1. Zhvlerësimi i llogarive të arkëtueshme

Zhvlerësimi i llogarive të arkëtueshme bazohet në humbjet e vlerësuar të cilat rezultojnë nga pa mundësia e konsumatorëve për të paguar detyrimet e tyre. Këto vlerësime bazohen në moshën e llogarive të arkëtueshme dhe eksperiencën e mëparshme në çregjistrimin, vlerësimin e aftësisë paguese të konsumatorëve, si dhe ndryshimet e fundit dhe të pritshme të termave të pagesës së konsumatorëve. Manaxhimi vlerëson në fund të çdo periudhe në rast se ka nevojë për zhvlerësimin e llogarive të arkëtueshme.

2.5.2. Provizionet

Provizionet në përgjithësi kërkojnë një nivel të lartë gjykimi, veçanërisht në rastet e konflikteve gjyqësore. Shoqëria vlerëson mundësinë e krijimit të një detyrimi aktual si rrjedhojë e një ngjarje të shkuar, në rast se mundësia e ndodhjes vlerësohet të jetë më shumë se 50% , në të tilla raste shoqëria provizionon vlerën e detyrimit e cila mund të matet me besueshmëri. Për shkak të nivelit të lartë të pasigurisë, në disa raste mund të ndodhë që vlerësimi mund të mos jetë në të njëjtën linjë me rezultatin e çështjes. Manaxhimi vlerëson në fund të çdo periudhe në rast se ka nevojë për krijimin e provizioneve.

2.6. Krahasueshmëria e informacionit kontabël

Siç paraqitet në Standardin Kombëtar të Kontabilitet të përmirësuar nr.1, në rastet e një ndryshimi në paraqitjen e pasqyrave financiare si pasojë e kërkesave të një standardi të ri, një përmirësimi në standard apo një ndryshimi në ligjin për Kontabilitetin dhe Pasqyrat Financiare”, informacioni krahasues duhet të riparaqitet për të korresponduar me paraqitjen e re, përveç rasteve kur riparaqitja e informacionit krahasues nuk mund të vlerësohet në mënyrë të besueshme.

Informacioni krahasues për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2014 është riparaqitur për të korresponduar me paraqitjen e re të pasqyrave financiare siç kërkohet nga Standardet Kombëtare të Kontabilitetit të përmirësuar.

3. Politikat Kontabël

Politikat kontabël të mëposhtme janë aplikuar në mënyrë konsistente në të gjitha periudhat e paraqitura në pasqyrat financiare.

3.1. Transaksionet në monedhë të huaj

Transaksionet në monedhë të huaj konvertohen në monedhën funksionale dhe regjistrohen me kursin e këmbimit në datën e transaksionit. Aktivitetet dhe detyrimet monetare në monedhë të huaj në datën e raportimit konvertohen në monedhën funksionale me kursin e këmbimit në datën e bilancit. Fitimi ose humbja nga këmbimi në zëra monetarë është diferenca që vjen nga këmbimi i një numri të caktuar njësisish të një monedhe të huaj në monedhën funksionale me kurse të ndryshme këmbimi në datat e këmbimit. Të drejtat dhe detyrimet jo-monetare në monedhë të huaj konvertohen në monedhën funksionale me kursin e këmbimit të datës së kryerjes së transaksionit ndërsa ato që maten me vlerë të

3. Politikat Kontabël

drejtë rikëmben në monedhën funksionale me kursin e këmbimit të datës kur është përcaktuar vlera e drejtë. Diferencat që rezultojnë nga kursi i këmbimit kalojnë në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve.

Kursi i këmbimit i monedhave të huaja më 31 dhjetor 2015 dhe 2014 është detajuar si më poshtë:

Kursi i këmbimit	2015	2014
Euro/LEK	137.28	140.14
USD/ LEK	125.79	115.23
GBP/LEK	186.59	179.48

3.2 Instrumentat financiarë

Instrumentat financiarë jo-derivativë përbëhen nga llogari të arkëtueshme, mjete monetare, hua të marra dhe të dhëna dhe llogari të pagueshme.

Instrumentat financiarë jo-derivativë njihen fillimisht me vlerën e drejtë plus çdo kosto transaksioni që lidhet me to, përveç siç përshkruhet më poshtë. Për instrumentat e mbajtur me vlerë të drejtë nëpërmjet fitim/humbjes, kostot e transaksionit kalojnë në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve. Në vijim të njohjes fillestare instrumentat financiarë jo-derivativë maten siç përshkruhet më poshtë.

Një instrument financiar njihet nëse Shoqëria bëhet palë në kushtet kontraktuale të instrumentit. Aktivet financiare çregjistrohen kur skadojnë të drejtat kontraktuale të shoqërisë mbi flukset e parasë së aktivitetit financiar ose kur shoqëria transferon aktivin financiar tek një palë e tretë pa mbajtur kontrollin ose gjithë risqet dhe përfitimet thelbësore të aktivitetit. Blerjet dhe shitjet normale të aktiveve financiare kontabilizohen në datën e transaksionit, që është data në të cilën shoqëria angazhohet të blejë apo të shesë aktivin. Detyrimet financiare çregjistrohen nëse detyrimet kontraktuale të shoqërisë skadojnë, shfuqizohen ose anulohen.

Mjetet monetare

Mjetet monetare përfshijnë arkën, llogaritë rrjedhëse dhe depozitat në të parë me bankat. Për qëllimin e pasqyrës së fluksit të parasë, mjetet monetare përfshijnë depozita me afat me një maturim prej tre muajsh ose më pak që nga data e fillimit.

Llogari të arkëtueshme

Llogaritë e arkëtueshme njihen fillimisht me vlerën e drejtë dhe më pas me kosto të amortizuar duke zbritur humbjen nga zhvlerësimi. Provizionj për zhvlerësimin e aktiveve të arkëtueshme llogaritet kur ka të dhëna se shoqëria nuk do të jetë në gjendje të mbledhë të gjitha detyrimet. Vështirësitë financiare të debitorit, mundësia që debitori të falimentojë ose riorganizimi i tij financiar konsiderohen tregues që llogaritë e arkëtueshme të zhvlerësohen. Shuma e provizionit llogaritet si diferencë midis vlerës së mbetur dhe vlerës aktuale të flukseve të ardhshme të parashikuara të parasë të skontuara me normën efektive të interesit.

Llogari të pagueshme

Llogaritë e pagueshme paraqiten me vlerën e tyre të drejtë dhe më pas me kosto të amortizuar, duke përdorur metodën e interesit efektiv.

Hua të marra dhe të dhëna

Huatë e marra dhe të dhëna njihen fillimisht dhe mbahen në vazhdim me vlerën e tregut, pa përfshirë koston e transaksioneve. Pas njohjes fillestare, huatë e marra dhe të dhëna paraqiten me kosto të amortizuar duke njohur në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve çdo diferencë midis koston dhe vlerës së pagueshme nominale përgjatë periudhës së huamarrjes duke u bazuar (si rregull) në interesin

3. Politikat Kontabël (vazhdim)

3.2. Instrumentat financiare (vazhdim)

efektiv. Interesat e njohura në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve janë përlogaritur mbi bazën e interesit nominal.

Vlera e drejtë

Vlerat e drejta të përlogaritura të mjeteve monetare dhe ekuivalentëve të tyre, të kërkesave për t'u arkëtuar, detyrimeve për t'u paguar dhe huave, përafrohen me vlerat e tyre kontabël.

Të tjera

Instrumenta të tjerë jo-derivativë maten me kosto të amortizuar sipas metodës së interesit efektiv, duke zbritur çdo humbje nga zhvlerësimi.

Kapitali aksionar

Kapitali aksionar njihet me vlerën nominale. Aksionet e zakonshme klasifikohen si kapitale.

Zhvlerësimi i aktiveve financiare

Një aktiv financiar konsiderohet i zhvlerësuar nëse ka të dhëna objektive që tregojnë se një apo disa ngjarje kanë efekte negative në flukset e ardhshme që parashikohet të burojnë nga aktivi.

Një zhvlerësim në lidhje me aktivin financiar, të matur me kosto të amortizuar, llogaritet si diferencë midis vlerës së mbetur dhe vlerës aktuale të flukseve të ardhshme të parashikuara të parasë të skontuara me normën efektive të interesit.

Aktivitet financiare të rëndësishme testohen për zhvlerësim në mënyrë individuale. Aktivitet e tjera financiare vlerësohen në mënyrë të grupuar, në grupe që kanë karakteristika të ngjashme të riskut kreditor.

Të gjitha humbjet nga zhvlerësimi njihen në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve.

Një humbje nga zhvlerësimi rimerret nëse rimarrja mund të lidhet objektivisht me një ngjarje të ndodhur pas njohjes së humbjes nga zhvlerësimi. Për aktivitet financiare të matura me kosto të amortizuar, rimarrja njihet në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve.

3.3. Inventarët

Inventarët regjistrohen në kontabilitet me kosto. Kosto e marrjes përfshin të gjitha shpenzimet e kryera për ta sjellë inventarin në vendin dhe kushtet ekzistuese. Në rastin e prodhimit të produkteve në kosto përfshihet edhe pjesa respektive e shpenzimeve të përgjithshme duke u llogaritur mbi kapacitetet normale prodhuese. Kosto e inventarit llogaritet duke përdorur metodën e mesatares së ponderuar.

Gjendjet e inventarit janë të vlerësuara në bilanc me koston e tyre historike, duke e konsideruar këtë vlerësim, si vlerën më të ulët midis koston dhe vlerës neto të realizueshme.

3.4. Aktive afatgjata materiale

i. Njohja dhe matja

Të gjitha aktivitet afatgjata materiale paraqiten me kosto duke zbritur zhvlerësimin dhe amortizimin e akumuluar.

Kostoja përfshin shpenzime të cilat lidhen drejtpërdrejt me blerjen e aktivitet. Kostoja e aktiveve të vetë-ndërtuara përfshin koston e materialeve dhe punës direkte, çdo kosto tjetër të lidhur drejtpërdrejt me sjelljen e aktivitet në gjendje pune për qëllimin e synuar të përdorimit, si dhe koston e çmontimit, heqjes së pjesëve dhe sjelljes në gjendjen e mëparshme të vendndodhjes së aktivitet. Shpenzimet kapitale të

3. Politikat Kontabël (vazhdim)

aktiveve të bëra gjatë ndërtimit kapitalizohen në "Ndërtim në proces" dhe transferohen në kategorinë përkatëse të aktivitetit kur përfundon ndërtimi tij, nga kur aplikohet amortizimi përkatës sipas kategorisë. Në rastet kur pjesë të një aktivi afatgjatë material kanë jetëgjatësi të ndryshme, ato kontabilizohen si zëra të ndryshëm (komponentët më të mëdhenj) të aktiveve afatgjata materiale.

Fitimet dhe humbjet nga shitjet, apo nxjerrjet jashtë përdorimit përcaktohen duke krahasuar vlerën e shitjes me vlerën e mbetur dhe këto përfshihen në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve.

ii. Kostot e mëpasshme

Kostoja e zëvendësimit të një pjese të një zëri të aktiveve afatgjata materiale njihet në vlerën kontabël të atij zëri nëse është e mundshme që shoqëria do të realizojë përfitime të ardhshme ekonomike nga përdorimi i pjesës zëvendësuese dhe kostoja e pjesës mund të matet në mënyrë të besueshme. Kostot e shërbimeve të zakonshme të aktiveve afatgjata materiale njihen si shpenzim kur ato ndodhin.

3.4. Aktive afatgjata materiale

iii. Amortizimi

Amortizimi i aktiveve llogaritet duke përdorur metodën e vlerës së mbetur të amortizimit mbi jetën e vlerësuar të çdo pjese të aktivitetit afatgjatë material duke filluar nga dita e parë e muajit që pason muajin e blerjes. Aktivitetet e marra me qira amortizohen duke marrë për bazë periudhën më të shkurtër midis periudhës së qirasë dhe jetës së dobishme të aktivitetit.

Jetëgjatësia e vlerësuar për vitin 2015 dhe 2014 është si më poshtë:

Aktive	Përqindja
Ndërtesa	5%
Pajisje zyre dhe informatike	25%
Automjetet	20%
Mobilje zyre	20%

iv. Çregjistrimi

Një zë i aktiveve afatgjata materiale çregjistrohet kur ai nxirret jashtë përdorimit apo atëherë kur nuk priten më përfitime ekonomike të ardhshme nga përdorimi apo nxjerrja e tij jashtë përdorimit. Fitimet dhe humbjet në rastin e nxjerrjes jashtë përdorimit të aktiveve afatgjata materiale, përcaktohen sipas shumës së tyre të mbetur dhe merren parasysh në nxjerrjen e rezultatit operativ të vitit.

3.5. Të ardhurat

Të ardhurat njihen atëherë kur është e mundshme që njësia ekonomike do të ketë përfitime ekonomike në të ardhmen dhe këto përfitime mund të maten me besueshmëri. Të ardhurat maten me vlerën e drejtë të arkëtuar ose të arkëtueshme që merr parasysh shumën e çfarëdo zbritje tregtare, zbritjet për shlyerje të menjëhershme dhe zbritjet e bëra për sasi (vëllim) të blerë.

3.6. Të ardhurat e tjera të shfrytëzimit

Të ardhurat e tjera të shfrytëzimit paraqesin të ardhurat që përfitohen jo rregullisht gjatë rrjedhës normale të veprimtarisë ekonomike duke përfshirë, fitim/humbjet nga shitja e aktiveve afatgjata materiale dhe jomateriale, fitim/humbjet nga rivlerësimet e aktiveve afatgjate të investuara dhe fitim/humbjet që vijnë nga ndryshimi i kursit të këmbimit përveç diferencave të këmbimit që lidhen me veprimtaritë financiare dhe investuese.

3. Politikat Kontabël (vazhdim)**3.7. Qiratë**

Qiramarrjet klasifikohen si financiare ose operative që në fillimin e qirasë. Qiratë financiare njihen si aktive dhe detyrime financiare në shkallën më të ulët të vlerës së drejtë të aktivitetit dhe vlerës aktuale të minimumit të pagesave të qirasë në datën e blerjes. Kostot financiare regjistrohen në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve nën termin e qirasë me normat e zbatueshme të interesit mbi balancën e mbetur të detyrimeve.

3.8. Të ardhurat dhe shpenzimet financiare

Të ardhurat financiare përfshijnë të ardhura interesi nga llogaritë bankare dhe fitime nga kursi i këmbimit që njihen në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve. Të ardhurat nga interesi njihen mbi bazën e të drejtave të konstatuara duke përdorur metodën e interesit efektiv.

Shpenzimet financiare përfshijnë shpenzime interesi mbi huamarrjet dhe humbjet nga kursi i këmbimit, ndryshimet në vlerën e drejtë të aktiveve financiare të mbajtura me vlerë të drejtë nëpërmjet llogarisë fitim/humbje dhe humbjet nga zhvlerësimi i aktiveve financiare. Kostot e huamarrjes njihen në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve me metodën e interesit efektiv.

3.9. Tatimi mbi fitimin

Tatim fitimi i vitit përbëhet nga tatimi aktual dhe tatim fitimi i shtyrë. Tatim fitimi njihet në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve përveç rasteve kur lidhet me zëra që njihen direkt në kapital, rast në të cilin edhe tatimi njihet në kapital.

Tatimi aktual është tatimi i pritur për t'u paguar mbi fitimin e tatueshem të vitit, duke aplikuar normat tatimore në fuqi në datën e bilancit, si dhe çfarëdolloj rregullimi kontabël të tatimit për t'u paguar në lidhje me vitet e mëparshme. Norma e tatimit mbi fitimin për vitin 2015 është 15% (2014: 15%).

Tatim fitimi i shtyrë përfaqëson diferencën e tatimit mbi fitimit të pagueshëm (apo të rikuperueshëm) në periudhat e ardhshme, i cili përlllogaritet për të evidentuar diferencat e përkohshme që krijohen për shkak të aplikimit të parimeve kontabël të ndryshme nga ato tatimore. Tatimi i shtyrë njihet sipas metodës së detyrimeve të bilancit, duke aplikuar normën tatimore në fuqi mbi diferencën ndërmjet aktiveve dhe detyrimeve për qëllime të raportimit financiar dhe vlerave të këtyre aktiveve dhe detyrimeve për qëllime tatimore.

Gjendjet e shtyra tatimore maten me normat tatimore në fuqi ose që konsiderohen në fuqi në fund të periudhës së raportimit, të cilat pritet të zbatohen për periudhën kur diferencat e përkohshme do të anulohen ose humbja tatimore e mbartur do të shfrytëzohet.

Aktivitetet tatimore të shtyra për diferencat e përkohshme të zbritshme regjistrohen deri në atë masë që është e mundur që fitimi i tatueshëm në të ardhmen të mund të përdoret për zbritjet në fjalë.

Shoqëria nuk ka njohur tatim të shtyrë për humbjet e mbartura fiskale.

3.10. Fondet për pensione

Shoqëria paguan kontributet ndaj sigurimeve shoqërore e shëndetësore të detyrueshme, që sigurojnë përfitimet për pensione të punonjësve në përputhje me legjislacionin shqiptar. Autoritetet Fiskale janë përgjegjëse për përcaktimin e kufirit minimal ligjor të vendosur për pensionet në juridiksionin përkatës sipas një plani kontributësh pensioni të përcaktuar.

3.11. Transaksionet me palët e lidhura

Palët e lidhura përcaktohen kur një palë kontrollohet nga pala tjetër, ose ka ndikim të rëndësishëm në vendimet e biznesit apo vendimet financiare të palës tjetër. Për qëllime të paraqitjes së pasqyrave financiare, drejtimi i shoqërisë dhe manaxhimi konsiderohen si palë të lidhura.

3. Politikat Kontabël (vazhdim)**3.12. Provizionet**

Një provizion njihet nëse, si rezultat i një ngjarjeje të shkuar, Shoqëria ka një detyrim ligjor apo konstruktiv, i cili mund të vlerësohet në mënyrë të besueshme dhe do të kërkojë në të ardhmen flukse dalëse parash për shlyerjen e tij. Provizionet përcaktohen duke skontuar flukset e pritshme të ardhshme të parasë me një normë skontimi para tatimit që pasqyron vlerësimet aktuale të tregut për vlerën në kohë të parasë dhe për risqet që lidhen me detyrimin në fjalë. Provizionet rishikohen në çdo datë raportimi dhe nëse nuk ka më gjasa për daljen e ndonjë fluksi parash për shlyerjen e detyrimit, provizionet rimerren.

3.13. Aktivet dhe detyrimet e kushtëzuara

Detyrimet e kushtëzuara nuk njihen në pasqyrat financiare. Ato paraqiten në shënime të pasqyrave financiare për sa kohë që mundësia për një dalje të burimeve që përfshijnë përfitime ekonomike është e largët. Një aktiv i kushtëzuar nuk paraqitet në pasqyrat financiare por paraqitet në shënime për sa kohë ekziston mundësia e hyrjes së përfitimeve ekonomike. Shuma e humbjeve të kushtëzuara njihet si provizion, nëse është e mundshme që ngjarjet e ardhshme të konfirmojnë që një detyrim ka lindur në datën e pozicionit financiar dhe mund të bëhet një vlerësim i arsyeshëm i shumës së humbjes.

4. Mjete monetare

Mjetet monetare në arkë dhe bankë detajohen si më poshtë më 31 dhjetor 2015 dhe 31 dhjetor 2014:

	<u>31 Dhjetor 2015</u>	<u>31 Dhjetor 2014</u>
Mjete monetare në bankë	36,642	25,536
Llogari rrjedhëse	36,642	25,536
Mjete monetare në arkë	13,338	13,338
Totali	<u>49,980</u>	<u>38,874</u>

5. Llogari të arkëtueshme tregtare

Llogaritë e arkëtueshme tregtare më 31 dhjetor 2015 dhe 31 dhjetor 2014 paraqiten si më poshtë:

	<u>31 Dhjetor 2015</u>	<u>31 Dhjetor 2014</u>
Klientë	15,307,674	15,307,674
Zhvlerësim i llogarivë të arkëtueshme	(15,307,674)	(15,307,674)
	<u>-</u>	<u>-</u>

Lëvizjet në zhvlerësimin e të drejtave për arkëtim paraqiten më poshtë:

	<u>31 Dhjetor 2015</u>	<u>31 Dhjetor 2014</u>
Gjendja më 1 Janar	15,307,674	15,307,674
Rimarrje për vitin 2015		
Zhvlerësimi për vitin 2015		
Gjendja më 31 Dhjetor	<u>15,307,674</u>	<u>15,307,674</u>

6. Llogari të arkëtueshme nga palët e lidhura

Llogaritë e arkëtueshme nga palët e lidhura më 31 dhjetor 2015 dhe 31 dhjetor 2014 paraqiten si më poshtë:

	<u>31 Dhjetor 2015</u>	<u>31 Dhjetor 2014</u>
Të arkëtueshme tregtare nga Emped shpk	3,803,203	3,783,201
	3,803,203	3,783,201

7. Të tjera llogari të arkëtueshme

Të tjera llogari të arkëtueshme detajohen si më poshtë më 31 dhjetor 2015 dhe 31 dhjetor 2014:

	<u>31 Dhjetor 2015</u>	<u>31 Dhjetor 2014</u>
Shteti – TVSH për t'u marrë	36,725	28,490
Tatim Fitimi	1,824,513	1,906,977
Të tjera	4,823,792	4,823,792
Totali	6,685,030	6,759,259

8. Inventari

Inventari i shoqërisë më 31 dhjetor 2015 dhe 2014 detajohet si më poshtë:

	<u>31 Dhjetor 2015</u>	<u>31 Dhjetor 2014</u>
Produkte dhe mallra	5,725,175	5,725,175
Të tjera gjendje inventari	87,100	87,100
Provizione për zhvlerësime	(5,725,175)	(5,725,175)
Totali	87,100	87,100

EUROGREN Sh.p.k
Shënime e Pasqyrave Financiare për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2015

(Vlerat janë në Lek)

9. Aktive Afatgjata Materiale

	Toka	Ndërtesa	Makineri Pajisje	Automjetet	Mobilje orendi	Totali
<i>Kosto</i>						
Gjendja më 31 dhjetor 2013	4,138,600	11,743,604	23,780,759	1,052,859	446,072	41,161,894
Shtesa						
Nxjerrje jashtë përdorimit						
Gjendja më 31 dhjetor 2014	4,138,600	11,743,604	23,780,759	1,052,859	446,072	41,161,894
Shtesa						
Nxjerrje jashtë përdorimit						
Gjendja më 31 dhjetor 2015	4,138,600	11,743,604	23,780,759	1,052,859	446,072	41,161,894
<i>Zhvlerësimi i akumuluar</i>						
Gjendja më 31 Dhjetor 2013		4,313,266	17,354,558	696,308	341,041	22,705,173
Amortizimi i vitit						
Nxjerrje jashtë përdorimit						
Gjendja më 31 dhjetor 2014	-	4,313,266.00	17,354,558.00	696,308.00	341,041.00	22,705,173
Amortizimi i vitit						
Nxjerrje jashtë përdorimit						
Gjendja më 31 dhjetor 2015	-	4,313,266.00	17,354,558.00	696,308.00	341,041.00	22,705,173
<i>Vlera neto kontabël</i>						
Gjendja më 31 dhjetor 2013	4,138,600	7,430,338	6,426,201	356,551	105,031	18,456,721
Gjendja më 31 dhjetor 2014	4,138,600	7,430,338	6,426,201	356,551	105,031	18,456,721
Gjendja më 31 dhjetor 2015	4,138,600	7,430,338	6,426,201	356,551	105,031	18,456,721

EUROGREN Sh.p.k
Shënimef e Pasqyrave Financiare për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2015

(Vlerat janë në Lek)

10. Aktivet Afatgjata Jomateriale

	AAJM	Total
Me kosto		
Gjendja më 31 Dhjetor 2014	4,980,000	4,980,000
Shtesa	-	-
Pakësime	-	-
Gjendja më 31 Dhjetor 2015	4,980,000	4,980,000
Amortizimi		-
Gjendja më 31 Dhjetor 2014	3,411,300	3,411,300
Gjendja më 31 Dhjetor 2015	3,411,300	3,411,300
Gjendja Neto më 31 Dhjetor 2014	1,568,700	1,568,700
Gjendja Neto më 31 Dhjetor 2015	1,568,700	1,568,700

11. Llogari të pagueshme tregtare

Llogaritë e pagueshme tregtare më 31 dhjetor 2015 dhe 31 dhjetor 2014 paraqiten si më poshtë:

	31 Dhjetor 2015	31 Dhjetor 2014
Furnitorë vendas	328	328
	328	328

12. Detyrime tatimore

Detyrimet tatimore për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2015 dhe 31 dhjetor 2014 detajohen si më poshtë:

	31 Dhjetor 2015	31 Dhjetor 2014
Sigurime shoqërore & shëndetsore	20,078	20,078
Tatimin mbi të ardhurat personale	2,600	2,600
	22,678	22,678

13. Të tjera detyrime

Detyrimet e tjera për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2015 dhe 31 dhjetor 2014 janë si më poshtë:

	31 Dhjetor 2015	31 Dhjetor 2014
Paga për t'u paguar	61,336	61,336
Debitorë & kreditorë të tjerë	267,737	267,737
	329,073	329,073

(Vlerat janë në Lek)

14. Llogari të pagueshme nga palët e lidhura

Llogaritë e pagueshme nga palët e lidhura për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2015 dhe 31 dhjetor 2014 paraqiten si më poshtë:

	<u>31 Dhjetor 2015</u>	<u>31 Dhjetor 2014</u>
Hua nga ortakët	30,191,167	28,543,739
	<u>30,191,167</u>	<u>28,543,739</u>

15. Kapitali aksionar

Kapitali i nënshkruar i shoqërisë është 51,776,625, i ndarë në 100 kuota.

Gjatë vitit 2015 nuk kanë ndodhur ndryshime në kompozimin e kapitalit të shoqërisë.

16. Të ardhura nga aktiviteti i shfrytëzimit

Të ardhurat nga aktiviteti i shfrytëzimit detajohen si më poshtë për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2015 dhe 31 dhjetor 2014:

	<u>Për vitin e mbyllur më 31 Dhjetor 2015</u>	<u>Për vitin e mbyllur më 31 Dhjetor 2014</u>
Të ardhura nga qeraja	1,800,000	1,680,000
	<u>1,800,000</u>	<u>1,680,000</u>

Rakordimi i të ardhurave me deklaratat e TVSH-së.

	<u>Për vitin e mbyllur më 31 Dhjetor 2015</u>
Rakordimi i të ardhurave me FDP-në e Tatim Fitimit	
Shitje total të deklaruar në FDP TVSH	1,800,000
Zbriten Autofaturimet	-
Shitje të deklaruar në FDP që janë të ardhura në PASH	<u>1,800,000</u>
Fitim nga këmbimet valutore	500,993
Të ardhura nga interesat	76
Total të ardhura të deklaruar FDP e Tatim Ftimit	<u>2,301,069</u>

(Vlerat janë në Lek)

17. Lënda e parë dhe materiale të konsumueshme

Në këtë zë paraqiten kostoja e mallrave, lëndeve të para dhe shërbimeve të konsumuara që lidhen me veprimtarinë e shfrytëzimit. Lënda e parë dhe materiale të konsumueshme detajohen si më poshtë për vitin e mbyllur me 31 dhjetor 2015 dhe 31 dhjetor 2014:

	Për vitin e mbyllur më 31 Dhjetor 2015	Për vitin e mbyllur më 31 Dhjetor 2014
Taksa të ndryshme lokale	595,420	595,420
Konsulenca ekonomike dhe juridike	40,000	40,000
Energji elektrike	1,175	781
Shpenzime administrative	1,200	1,200
Komisione bankare	4,550	5,500
	642,345	642,901

18. Shpenzime të personelit

Shpenzimet e personelit detajohet si më poshtë për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2015 dhe 31 dhjetor 2014:

	Për vitin e mbyllur më 31 Dhjetor 2015	Për vitin e mbyllur më 31 Dhjetor 2014
Shpenzime për paga	864,000	864,000
Shpenzime për sigurime shoq. e shëndetësore	144,288	144,288
	1,008,288	1,008,288

Numri i punonjësve më 31 Dhjetor 2015 është 2 punonjës (2014: 2 punonjës).

19. Shpenzime financiare

Shpenzimet financiare përfshijnë shpenzimet e interesit dhe rezultatit nga kursi i këmbimit që lidhet me aktivitetin financiar të shoqërisë. Ky zë detajohet si më poshtë për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2015 dhe 31 dhjetor 2014:

	Për vitin e mbyllur më 31 Dhjetor 2015	Për vitin e mbyllur më 31 Dhjetor 2014
Shpenzime për interesa	(2,243,420)	(2,123,241)
Të ardhura nga interesat	76	-
Të ardhura nga këmbimet valutore	500,993	9,731
	(1,742,351)	(2,113,510)

EUROGREN Sh.p.k
Shënime e Pasqyrave Financiare për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2015

(Vlerat janë në Lek)

20. Shpenzimi i tatimit mbi fitimin

Përlllogaritja e shpenzimit për tatimin mbi fitimin paraqitet më poshtë për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2015 dhe 31 dhjetor 2014:

	Për vitin e mbyllur më 31 Dhjetor 2015	Për vitin e mbyllur më 31 Dhjetor 2014
<i>Fitimi para tatimit</i>	(1,592,984)	(2,084,699)
Shpenzime të panjohura të tjera (si më poshtë)	2,243,420	2,123,241
Shpenzime interesash të panjohura	2,243,420	2,123,241
<i>Fitimi para tatimit (përfshirë shpenzimet e panjohura)</i>	650,436	38,542
Humbje fiskale e mbartur	650,436	38,542
<i>Tatim fitimi @15%</i>	97,565	5,781
	<u>(1,690,549)</u>	<u>(2,090,480)</u>

21. Transaksionet me palët e lidhura

Balancat me palët e lidhura më 31 dhjetor 2015 dhe 31 dhjetor 2014 paraqiten si më poshtë:

	31 Dhjetor 2015	31 Dhjetor 2014
<i>Të pagueshme ndaj palëve të lidhura</i>		
Hasan Hafizi	10,063,723	9,514,580
Edmond Mersini	10,063,722	9,514,580
Mirela Mula	10,063,722	9,514,579
	<u>30,191,167</u>	<u>28,543,739</u>
	31 Dhjetor 2015	31 Dhjetor 2014
<i>Të arkëtueshme nga palët e lidhura</i>		
Emped Shpk	3,803,203	3,783,201
	<u>3,803,203</u>	<u>3,783,201</u>

Transaksionet me palët e lidhura për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2015 dhe 31 dhjetor 2014 paraqiten si më poshtë:

	Për vitin e mbyllur më 31 Dhjetor 2015	Për vitin e mbyllur më 31 Dhjetor 2014
Shitje		
Emped shpk	1,800,000	1,680,000
	<u>1,800,000</u>	<u>1,680,000</u>

22. Angazhime dhe pasiguri

Çështje gjyqësore

Gjatë aktivitetit të saj të zakonshëm, Shoqëria mund të përfshihet në pretendime apo veprime të ndryshme ligjore nga palë të treta. Bazuar në opinionin e drejtuesve të Shoqërisë, konkluzioni përfundimtar në lidhje me këto çështje nuk do të ketë efekte negative në pozicionin financiar të Shoqërisë ose ndryshime në aktivet neto të saj. Më 31 Dhjetor 2015 Shoqëria nuk ka asnjë çështje gjyqësore të hapur kundrejt saj apo nga ajo, që mund të kërkojë rregullime të këtyre pasqyrave financiare.

24. Ngjarje pas bilancit

Nuk ka asnjë ngjarje pas datës së bilancit e cila kërkon rregullime apo shpjegime në këto pasqyra financiare.

